



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

BASHKIA PËRMET



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA  
DISKRIMINIMI

Nr. 953 Prot, datë 11.12.2012

Nr. 454/19 Prot, datë 12.12.2012

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI  
NDËRMJET  
KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI  
DHE  
BASHKISË PËRMET**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Bashkia Përmet (në vijim të quajtura "Palët")

*Duke vlerësuar* rëndësinë e promovimit, garantimit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit;

*Duke u angazhuar* për marrjen përsipër për sigurimin e të gjitha mjeteve të nevojshme

për mbrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;

*Duke konsideruar* si domosdoshmëri ushtrimin e ndërsjelltë të veprimtarisë institucionale me qëllim realizimin e interesave të ligjshme të personave mbështetur në parimin e barazisë përpara ligjit dhe barazisë së shanseve e mundësive për të ushtruar të drejtat e për të gëzuar liritë;

*Duke afirmuar* vullnetin e mirë dhe vendosmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në funksion të realizimit të qëllimit të këtij memorandumimi;

*Duke u mbështetur* në kuadrin e plotë ligjor që rregullon veprimtarinë e tyre institucionale dhe administrative: në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar;

*Kanë rënë dakord* të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi (në vijim “Memorandum”).

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij Memorandumit është, bashkërendimi i ndërsjelltë dhe reciprok i veprimtarisë institucionale të punës midis Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Bashkisë Përmet, me qëllim ndjekjen, kujdesjen, garantimin, ofrimin e shërbimeve cilësore duke marrë në konsideratë realizimin e interesit më të lartë të qytetarit, për marrjen pjesë në jetën publike, si dhe mbrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi apo çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, në funksion të respektimit dhe zbatimit të Kushtetutës , ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe legjislacionit në fuqi.



